



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 5

Prishtinë, më 14.11. 2017, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Haxhi Shala, kryetar, Rexhep Selimi, zëvendëskryetar i parë, Zoran Mosilović, zëvendëskryetar i dytë, Ismet Beqiri, Blerim Kuçi, Drita Millaku, Fadil Beka, Fatmir Xhelili, dhe Bahrim Shabani, anëtarë.

Mungoi: Ramiz Kelmendi, Xhelal Sveçla

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Gramoz Paqarada-KDI, Dhurata Kryeziu-OSBE, Njomza Arifi-praktikante.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

Mbledhjen e kryesoi, Haxhi Shala, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e komisionit e mbajtura me datë 24.10.2017;

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-214;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 06/L-014 për Infrastrukturë Kritike;
5. Të ndryshme.

Kryetari i komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e komisionit e mbajtura me datë 24.10.2017.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-214.

Kryetari, fillimisht theksoi se, projektligji i si i tillë i plotëson kushte për tu proceduar në Kuvend për miratimin në parim të tij, propozoi votimin e tij dhe procedimin në seancë.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në këtë pikë të rendit të ditës nxori këtë:

REKOMANDIM

Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-013 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-214. Projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit për tu proceduar për shqyrtim të parë në mbledhje plenare dhe i rekomandon Kuvendit, miratimin e tij në parim.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit 06/L-014 për Infrastrukturë Kritike.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në këtë pikë të rendit të ditës nxori këtë:

REKOMANDIM

Miratohet në parim Projektligji Nr. 06/L-014 për Infrastrukturë Kritike. Projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit për tu proceduar për shqyrtim të parë në mbledhje plenare dhe i rekomandon Kuvendit, miratimin e tij në parim.

5. Të ndryshme.

Kryetari, lidhur me tryezën e rrumbullakët e organizuar nga DCAF me temë **Qeverisja dhe Mbikëqyrjen e Sektorit të Sigurisë**" me datë 8 nëntor, theksoi se ka qenë mjaft e dobishme dhe temat që janë trajtuar kanë qenë relevante.

Fatmir Xhelili, lidhur me këtë tryezë, theksoi se ka qenë e dobishme dhe diskutimet për çështjet e sigurisë, mbikëqyrjen e institucioneve ekzekutive. Për këtë falënderoi DCAF për këtë organizim duke shpresuar në bashkëpunimin e mëtutjeshëm.

Kryetari, ndërsa sa i përket planifikimeve për aktivitetet e radhës së Komisionit, propozoi që vizita e radhës të jetë në Ministrinë e FSK-së, duke qenë se edhe buxheti për vitin 2018 do të procedohet në Kuvend, mund të diskutohet edhe për këtë çështje.

Rexhep Selimi, sa i përket procedurës së shqyrtimit të projektligjeve, thekso se për të qenë sa më efektiv, janë ftuar edhe përfaqësuesit e ministrive të linjës. Ndërsa sa i përket planifikimit të buxhetit, theksoi se është gatishmëria edhe nga ana e Komisionit për të ofruar mbështetje dhe kontribut, siç mund të jetë FSK-ja dhe Policia e Kosovës.

Fatmir Xhelili, sa i përket planifikimeve buxhetore, theksoi se tashmë institucionet kanë bërë planifikimit dhe projekt buxheti për 2018 është proceduar në Kuvend. Ndërsa sa i përket rolit mbështetës për resorë të caktuara, theksoi se kjo mund të bëhet duke identifikuar ato projekte për të cilat ata kanë bërë kërkesë por nuk janë realizuar.

Kryetari, theksoi se vizita e radhës në Ministrinë e FSK-së është e planifikuar në planin e punës dhe qëllimi i kësaj vizite është më shumë për tu njohur me punën dhjetë vjeçar të Ministrisë së FSK-së.

Komisioni për Punë të Brendshme, siguri dhe mbikëqyrje të FSK-së pas diskutimeve nxori këtë:

PËRFUDNIM

Komisioni do të realizoj vizitë punë në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, me datë 21 nëntor 2017.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur

Mbledhja përfundoi në orën 10:40

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Haxhi Shala

